



UNIVERSITETI I MITROVICËS

UNIVERSITY OF MITROVICA "ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Datë 08.07.2016

Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"

Shpall

KONKURS

për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e Universitetit të Mitrovicës

I. Fakulteti i Gjeoshkencave

1. Një mësimdhënës për lëndët: Bazat e shkencës së materialeve I, Bazat e shkencës së materialeve II, Analiza e strukturës dhe mikrostrukturës I dhe Materialografia.
2. Një mësimdhënës për lëndët: Bazat e Gjeokimisë, Petrografi teknike, dhe Metodatat instrumentale të studimit të mineraleve.
3. Një mësimdhënës për lëndët: Mineralogjia e përgjithshme, Mineralogjia speciale, Bazat e mineragrafisë, Optika e mineraleve metalore dhe Izotopet në gjeologji.
4. Një mësimdhënës për lëndët: Gjeologjia e Kuarternarit, Gjeologjia mjedisore, Mbrojtja e Mjedisit dhe Gjeokimi e Mjedisit.
5. Një asistent për grup lëndësh në Departamentin e Gjeologjisë.

II. Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

1. Një mësimdhënës për lëndët: Mikrobiologji e ushqimit, Teknologji e fermentimit, Teknologji e përpunimit të qumështit, dhe Kimia dhe teknologjia e qumështit dhe produkteve të tij.
2. Një mësimdhënës për lëndët: Kimia organike I, Kimia organike II dhe Kromatografia (HPCL e gaztë).
3. Një mësimdhënës për lëndët: Fizika, Fizika I dhe Fizika II.
4. Një asistent për lëndët: Biologji, Biokimi e përgjithshme dhe Gjenetika molekulare.
5. Një asistent për lëndët: Matematika I, dhe Matematika II.

III. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike

1. Një mësimdhënës për lëndët: Bazat e elektroteknikës, Komponentët elektronikë, Sistemet operative dhe Arkitekturë e avancuar e kompjuterëve.
2. Një mësimdhënës për lëndët: Kompjuterika I, Kompjuterika II, Elektronikë dixhitale dhe Mikroprocesorët dhe mikrokompjuterët I.
3. Një mësimdhënës për lëndët: Mikroekonomi, Menaxhim i burimeve njerëzore, Marketing, Makroekonomi, Bazat e menaxhimit të ndërmarrjeve dhe Biznes ndërkombëtar.
4. Një asistent për grup lëndësh në Informatikë Inxhinierike.

Personeli akademik do të angazhohet për mësimdhënie akademike dhe kërkime shkencore.

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

- Kandidatet që paraqiten në konkurs duhet të dorëzojnë:
- Kërkesën për aplikim
- Një cv profesionale, shkarko në këtë link: www.umib.net
- Certifikatën e lindjes-origjinale;

- Kopjen e diplomës përkatëse, të vërtetuar nga organi kompetent;
- Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale;
- Kopjen e vendimit për nostrifikimin e diplomës, të vërtetuar nga organi kompetent (vetëm kandidatet që kanë fituar diplomë doktorate ose masteri jashtë vendit);
- Vendimin e zgjedhjes së fundit (vetëm kandidatët të cilët janë të punësuar në ndonjë institucion të arsimit të lartë publik në Kosovë);
- Si dhe informata tjera, të cilat konsiderohen të rëndësishme për aplikantin.

Paraqitja e dokumenteve bëhet në fakultetin përkatës. Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike. Përveç kopjes fizike dokumentet duhet të dorëzohen edhe në formë elektronike (të skanuara), në adresën konkursi.personeliakademik2016@umib.net

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes në gazetë, respektivisht deri më datën 22.7.2016.

Aplikacionet e arritura pas afatit, si dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar në: www.umib.net

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni Administratën e fakulteteve përkatëse në numrat e tel: 028 530 446- Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore; dhe 028 534179 Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, prej orës 08:00 – 16:00.

